

VENDIM
Nr. 823, datë 21.10.2020

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 914, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT
PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në nenin 47/1, “Dhënia e kontratave sipas marrëveshjes kuadër”, të vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen pikat 7 e 8, me këtë përmbajtje:

“7. Përjashtimisht nga sa është përcaktuar në këtë nen, gjatë gjendjeve të epidemisë të deklaruar zyrtarisht sipas legjislacionit në fuqi, ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionet e saj të varësisë mund të prokurojnë mallra ose shërbime që mbulohen nga një marrëveshje kuadër nga operatorë ekonomikë të tjerë që nuk janë pjesë e marrëveshjes kuadër, në rast se operatorët ekonomikë të marrëveshjes kuadër kanë deklaruar me shkrim që, për shkak të gjendjes së epidemisë, janë në pamundësi për të përmbushur plotësisht ose pjesërisht detyrimin për të furnizuar mallrat ose shërbimet sipas marrëveshjes kuadër.

8. Në çdo rast, autoriteti kontraktor, përpara fillimit të çdo procedure të prokurimit publik për mallra ose shërbime që mbulohen nga një marrëveshje kuadër që nuk janë pjesë e marrëveshjes kuadër, sipas pikës 7, të këtij neni, është i detyruar për të kërkuar fillimisht furnizimin e mallrave ose të shërbimeve nga operatorët ekonomikë që kanë lidhur një marrëveshje kuadër.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe